

dhe ata filluan të tërhiqeshin drejt fshatit **Dujakë/Dujak**. Përderisa po e kalonin lumin, befasisht u paraqiten forcat serbe dhe filluan të qëllonin mbi pjesëtarët e UÇK-së. Një plumb pushke e ka qëlluar Asllanin në kokë duke e lënë të vdekur në vend. Trupi i tij ka mbetur në ujë deri te dita e nesërme, kur pjesëtarët e UÇK-së e tërhoqën dhe varrosen në Dujakë/Dujak. Mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Hereç/Ereç, më 1.08.1999.

**Burimet:** deklarata D.R, FDH-29209; deklarata A.S, FDH-29211; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Mentor (Smajl) Shabanaj

(31.07.1965, shqiptar nga Hereçi/Ereç, komuna e Gjakovës/Đakovica, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Mentori punonte në fabrikën e *Erenikut* në Gjakovë/Đakovica. Diku nga fundi i muajit mars të vitit 1998, ai me vëllain u bënë pjesëtarë të UÇK-së në Hereç/Ereç. Stërvitjet ushtarake i kanë kryer në fshatin Gllogjan/Glodane. Herët në mëngjes të datës **9.08.1998**, nga ora 06:00, forcat serbe kanë depërtuar në fshat dhe përmes megafonave i kanë ftuar pjesëtarë të UÇK-së që të dorëzoheshin. Pas pak, ka nisur edhe sulmi mbi fshatit. Mentori gjendej në pozicionin luftarak në *Mëhallën Shabanaj*. I vëllai u nis që ta merrte mitralozin, i cili gjendej në shtëpinë e axhës së tyre. Pasi u vonua, Mentori u nis për ta kërkuar atë, por përderisa i afrohej shtëpisë së axhës, e vërejtën forcat serbe. Shtënë mbi të dhe e qëlluan për vdekje në vend [**Hereç/Ereç**]. Pjesëtarët e forcave serbe e kanë marrë trupin e Mentorit dhe të shqiptarëve të tjerë, të cilët kanë rënë në betejë atë ditë në fshat, dhe i varrosën në varrezat e Gjakovës/Đakovica, më 13.08.1998. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Mentorit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin Hereç/Ereç, më 1.08.1999.

**Burimet:** deklarata A.S, FDH-29211; deklarata F.F, FDH-29212; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 132, FDH-23857.

### Shaban (Ramë) Fetaj

(19.06.1927, shqiptar nga Hereçi/Ereç, komuna e Gjakovës/Đakovica, udhëheqës në fabrikën e Erenikut, gjashtë fëmijë)

### Muhamet (Ukë) Zenunaj

(25.02.1934, shqiptar nga Hereçi/Ereç, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, tetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Muhameti dhe Shabani ishin miq shumë të mirë. Për shkak të angazhimit të tij për Kosovën Republikë që nga viti 1950, Shabani i ka kaluar dy vjet në burg. Në datën 6.08.1998, shumica e grave dhe fëmijëve e kanë braktisur Hereçin/Ereç, ndërkaq në fshat kanë mbetur vetëm pjesëtarët e UÇK-së nga ky fshat dhe Gjakova/Đakovica. Më **9.08.1998**, familjarët e Shabanit, përpos bashkëshortes së tij, po ashtu, i kanë braktisur shtëpitë e veta, sepse forcat serbe e nisën sulmin kundër fshatit. Shabani dhe Muhameti u pozicionuan në oborrin e Shabanit dhe kjo ishte hera e fundit që mbaheshin në mend të shiheshin të gjallë. Në mbrëmje të së njëjtës ditë, familjarët e Shabanit kanë mësuar nga një rom, pjesëtar i UÇK-së, se Shabani dhe Muhameti kanë rënë gjatë betejës që e zhvilluan nga oborri i Shabanit [**Hereç/Ereç**]. Forcat serbe i kanë çuar trupat e tyre në Gjakovë/Đakovica, ku ata u varrosën në varrezat e qytetit nga ana e punëtorëve të NPK *Çabrat/Čabrat*, më 13.08.1998. I biri i Shabanit, i cili me familjen u strehua në fshatin Brekoc/Brekovac, ka rënë në kontakt me romët, të cilët i kishin varrosur viktimat e fshatit [Hereç/Ereç]. Së bashku, ata shkuan në varrezat e Gjakovës/Đakovica, ku i hapën katër varre. E identifikuan Shabanin, Muhametin, Dinë Alijajn, ndërkaq kufoma e katërt ishte e panjohur për ta. Pas përfundimit të luftës, u konstatua se bëhej fjalë për Haxhi Isufin [të shikohet regjistrimi më poshtë]. Mbetjet mortore të të rënëve nga Hereçi/Ereç janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në këtë fshat, më 1.08.1999.

**Burimet:** deklarata F.F, FDH-29212; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Haxhi (Tahir) Isufi

(2.01.1930, shqiptar nga Hereçi/Ereç, komuna e Gjakovës/Đakovica, pensionist, shtatë fëmijë)